



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 474/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxha kryesues, Vlastimir Dimić dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REUZOHET** ankesa si e pabazuara e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

### **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në Qendrën e Votimit (QV) në fshatin Kishnicë, ka pas parregullsi gjatë procesit të ngase kryesuesi i vendvotimit nga radhët e subjektit politik LDD ka bërë fushat para votuesve duke prezantuar oferta zgjedhore, që konsiderohet se është në kundërshtim më nenin 6 paragrafi 1 pika e Rregullës Zgjedhore nr.09/2009.

Parashtruesi i ankesës nuk ika bashkangjitur asnjë provë ankesës.

Në raportin e Policisë të datës 13.12.2010, me nr.SPJ-AS-1/0266/10, theksohet se nuk ka pas asnjë paraqitje të ndonjë rasti i cili ka të bëjë më QV e lartcekur po ashtu në raport të policisë potencohet se nuk ka pas asnjë kërkesë nga menaxheri i kësaj QV për ndonjë problem në këtë Qendër të Votimit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku*

*mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pretendimet e bëra nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkaku se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë nga kryesuesi i Vendvotimit që ka qenë nga radhët e subjektit politik LDD, siç potencohet në ankesë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 474/2010 më datën 14.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxha**

